

VENDIM
Nr.188, datë 17.3.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR “HIMARË E VJETËR – POTAM”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor “Himarë e Vjetër – Potam”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen 1 286 (një mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë) m², tokë truall, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 4 115 200 (katër milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 200 000 (dyqind mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 4 115 200 (katër milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 30.3.2010 dhe të përfundojë më 30.6.2010.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ta bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “HIMARË E VJETËR-POTAM”.

N r	Emri	Atësi a	Mbiemri i	Z. Kadast.	Nr. Regjist. hipotekor	Sip m ² (truall)	Çmimi	Vlera	Vlera totale(lekë)	Shënime
1	Katina		Kacelano	1952	1027	92	3200	294400	294400	Vërtetim hipotekor
2	Koste		Dhima	1952	708	839	3200	2684800	2684800	Vërtetim hipotekor
3	Nikollaq		Duko	1952	87	355	3200	1136000	1136000	Vërtetim hipotekor
	Totali					1286		4115200	4115200	

